



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:016125

Datë: 24.01.2022

Numri i dokumentit: 02635703

E.nr.999/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorës A.A. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Labinot Buzuku nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 24.01.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.999/21**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.999/21, të datës 30.08.2021, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor C.nr.125/21, të datës 08.04.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 05.11.2021, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,740.68 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.999/21, më datë 24.01.2022

GJYQTARI
Faton Ajvazi